

TENDENCAT E DIVORCEVE DHE SHKAQET E TYRE PSIKOLOGJIKE TEK ÇIFTET SHQIPTARË

VALBONA TRESKA

Shkolla e mesme "Sami Frashëri", Tiranë

AKTET V, 4: 590 - 595, 2012

PERMBLEDHJE

Gjatë punës sime disa vjeçare pranë gjykatave të rretheve, ajo ç'ka bie më shumë në sy, është mënyra e divorcimit të bashkëshortëve, e cila përcakton më pas të gjithë procesin e zgjidhjes së martesës, si dhe pasojat që rrjedhin prej saj, përfshi këtu përcaktimin e përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijëve të mitur. Ky punim kërkon të sjellë në vëmendje format e divorcimit të çifteve në Shqipëri, shkaqet e këtyre mënyrave të divorcimit si dhe qëndrimet e vetë palëve në proces lidhur me mënyrën e divorcimit.

Fjalët kyçe: divorc, shqipëtare, mënyra, shkaqe, psikologjike.

HYRJE

Divorci, një prej problemeve më të mëdha sociale mbarë botërore, ka nisur të rritet me hapa të shpejtë edhe në Shqipëri. Në vitin 2010 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë u gjykuan 1406 çështje për zgjidhje martese ¹.

Kjo shifër konstatohet të jetë në fakt vetëm maja e ajsbergut. Pjesa më e madhe e bashkëshortëve, pavarësisht problemeve dhe dhunës në familje shtynjë për vite me rradhë zgjidhjen ligjore të martesës, apo jetojnë de facto të veçuar.

Shpesh artikujt e gazetave apo studimet e vogla realizuar për divorcet, flasin vecanërisht për shifra e më pak për shkaqet që cojnë në një prishje martese. Nuk ka studime të thelluara mbi arsyet psikologjike të divorceve në Shqipëri, e aq më pak të mënyrave të divorcimit të bashkëshortëve mes tyre. Gjendja psikologjike e bashkëshortëve, konfliktet mes tyre, divorcet e dhunshme, përfshirja e familjarëve, apo divorcet e qeta ku bashkëshortët bashkëpunojnë mes tyre, bëhen përcaktues të të gjithë procesit ligjor të zgjidhjes së martesës, caktimit të ushtrimit të përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijëve të mitur, si dhe marrëdhënieve që prindërit do të vazhdojnë të kenë mes tyre pas përfundimit të procesit.

Lidhur me këtë çështje faktet e rasteve ekstreme të dhunës në familje të ndodhura nën efektin e procesit të divorcimit, shfaqin dukshëm problemet që has familja shqipëtare në këndvështrimin ende tabu të fenomit si dhe përfshirjen në proces jo vetëm të bashkëshortëve, por familjeve të tyre përkatëse apo deri në përfshirjen e fiseve mes tyre.

Në artikullin e dt.03.07.2009 botuar në Gazetën Shqiptare raportohet se, Petrit Zaimi pas një konflikti me familjen e bashkëshortes ka qëlluar e ka vrarë me armë zjarri djalin e tij 13 vjeç dhe vjehrrin. Më pas ka goditur veten. Vjehrra ka mbetur e plagosur. Bashkëshortët Zaimi sapo kishin dalë nga një proces divorci .

Në korrik të vitit 2002 ditën e shpalljes së vendimit të zgjidhjes së martesës me bashkëshorten nga Gjykata e Tiranës, Roland Cama qëllon për vdekje vjehrrin e bashkëshorten dhe lë të plagosur rëndë vjehrrën. Ai vetvritet pak minuta më pas. Ngjarja ka ndodhur në prani të fëmijës së çiftit i cili në atë kohë ishte vetëm 3 vjeç. Aktualisht familjet vazhdojnë të jenë të konfliktuara dhe në proces gjyqësor për të drejtën e takimit të gjyshërve nga ana e babait me nipin.

Në shkurt të vitit 2008 Përparim Vrapi rreh dhe u shkakton plagë të rënda vjehrrës dhe bashkëshortës në prezencë të vajzës së mitur. Bashkëshortët ishin në proces divorci.

Fakte të tilla gjen vazhdimisht në faqet e shtypit të shkruar, ndërkohë që puna e përditshme me divorcet shfaq një numër të lartë të divorceve konfliktuale, të dhunshme e aspak bashkëpunues mes tyre.

QËLLIMI I STUDIMIT

Studimi i realizuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë është përpjekur që të operacionalizohet në çështje konkrete dhe reale.

Ai synon t'u japë përgjigje tre pyetjeve kryesore të ngritura me qëllim përfitim të rezultateve konkrete.

1. Cilat janë format e divorcimit të çifteve shqiptare?
2. Cilat janë shkaqet psikologjike që përcaktojnë format e divorceve?
3. Cilat janë qëndrimet e çifteve në divorc lidhur me marrëdhënien që ata mbajnë gjatë realizimit të zgjidhjes së martesës?

METODOLOGJIA

Studimi ekzaminon se në ç'mjedis psikologjik realizohen zgjidhjet e martesës, duke vlerësuar jo vetëm marrëdhënien mes bashkëshortëve e fëmijëve, por edhe me mjedisin familjar ku përkasin këta çifte.

Janë analizuar historitë personale të 150 çifteve në proces divorci në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Paraqitja e rezultateve të përfuara do të jetë një ndërthurje rezultatesh kuantitative dhe kualitative. Për kryerjen e studimit u përdor triangulimi i metodave kërkuese ku u përfshin:

1. Intervista të thelluara individuale me çifte në proces divorci.
2. Anketa
3. Studim i materialit (dosjeve gjyqësore), përfshi vlerësimin psikologjik të realizuar nga eksperti psikolog me kërkesë të gjykatës për palët në proces.

REZULTATET E PËRFUARA

Nga 150 çifte të përfshirë në këtë studim 51% e tyre ishin femra të moshës nga 22-48 vjeç dhe 49% meshkuj të moshës nga 27-54 vjeç. Çiftet që kanë marrë pjesë në studim kanë qenë prindër të fëmijëve të mitur.

Në 4% të rasteve të analizuara informacioni për bashkëshortin është marrë nga familjarë të tij për shkak të mungesës së kontakteve për një kohë të gjatë mes tij, bashkëshortes e fëmijëve. Në 2% të rasteve ka qenë nëna ajo që ka humbur kontaktet me bashkëshortin dhe fëmijën/ët.

1. Cilat janë format e divorceve mes çifteve shqiptare?

U vu re se pjesa dërrmuese e zgjidhjeve ligjore të martesave realizohet me kërkesë padi nga njëri prej bashkëshortëve.

Në çiftet në studim vetëm 5% e tyre realizuan divorcin me projekt-marrëveshje. 95% ju drejtuan gjykatës me kërkesë padi.


Bashkëshortët të cilët realizojnë projekt-marrëveshje ruajnë komunikim të mirë mes tyre, kanë kontakte të shpeshta me fëmijët dhe ndihmojnë bashkarisht ekonomikisht në rritjen dhe edukimin e fëmijëve në 100% të rasteve të marra në shqyrtim.

95% e divorceve me kërkesë padi mund ti kategorizojmë në dy lloje, divorce konfliktuale dhe të dhunshme dhe divorce jo konfliktuale.

Sjell në vëmendje se divorcet të konsideruara jo konfliktuale gjatë realizimit të këtij studimi janë konsideruar ato tipe procesesh ku bashkëshortët, ndonëse vijnë nga një mjedis konfliktual që kanë patur në familjen e përbashkët, vazhdojnë të ruajnë komunikimin mes tyre dhe fëmijës/ve si dhe mbështesin ekonomikisht partnerin që vazhdon të kujdeset për fëmijën/ët.

69.2% e divorceve me kërkesë padi kualifikohen si divorce konfliktuale apo të dhunshme ku përveç bashkëshortëve në proces, konflikti gjeneron edhe tek fëmija/ët apo mjediset familjare të secilit prej bashkëshortëve. (Graf 1.)

Graf 1.



Në 46.4% e divorceve konfliktuale njëri prej bashkëshortëve ka shkëputur kontaktet me fëmijën/ët për periudha kohe që variojnë nga disa muaj deri në 9 vjet.

- *Mia 10 vjeç ka shkëputur marrëdhëniet me të atin që kur ka qenë 6 muajshe për shkak të konflikteve mes prindërve.*

- *Adelajda 11 vjeç nuk kishte kontakte prej 3 vitesh me të ëmën dhe motrën për shkak të konflikteve mes prindërve.*

- *Albani 10 vjeç dhe e motra e tij 8 vjeç nuk kishin asnjë kontakt me nënën që kur ajo ishte larguar nga banesa bashkëshortore për shkak të konflikteve me të shoqin një vit më parë.*

- *Livia 3.5 vjeç nuk e njihte fare të atin për shkak të konflikteve mes prindërve dhe familjeve të tyre përkatëse që kur ajo ishte 7 muajshe e prindërit ishin veçuar. Takimi me babain u bë vetëm gjatë periudhës së procesit gjyqësor me ndërhyrjen e psikologes.*

Nuk janë të pakta rastet ku njëri prej bashkëshortëve mban të vëzhguar e të izoluar fëmijën/ët, për të shmangur kontaktet me prindin tjetër.

Problematika e të bërit pjesë të konfliktit familjet përkatëse ka rezultuar në shifra të larta gjatë këtij studimi. Në 57.2% të divorceve konfliktuale familjet bëhen pjesë e konfliktit.

Ka rezultuar gjithashtu se në 26.1% të divorceve konfliktuale, njëri prej bashkëshortëve është dhunuar fizikisht gjatë periudhës së procesit të divorcit apo është kërcënuar me jetë nga bashkëshorti/ja apo familjarë të tyre.

- *A.T është kërcënuar sëbashku me të bijën me armë nga bashkëshorti gjatë realizimit të divorcit.*

- *N.D është dhunuar rëndë fizikisht përpara djemve dhe është çuar me dhunë në mes të natës tek varrezat si kërcënim për të mos realizuar zgjidhjen e martesës.*

- *M.E u aksidentua me makinën e saj, për shkak të ndjekjes po me makinë nga bashkëshorti, si presion ndaj zgjidhjes së martesës të kërkuar prej saj.*

Gjatë studimit të realizuar u konstatua se pjesa më e madhe e partnerëve që kërcënoheshin e dhunoheshin ishin të seksit femër.

Nga analizimi i të dhënave u konstatua se 9% e njërit prej partnerëve në proces divorci ka insistuar deri në fund të procesit që të mos realizohet zgjidhja e martesës dhe në disa raste këta partnerë janë bërë shkak për zvarritjen e zgjidhjes ligjore.

Në këto raste është konstatuar se ka patur marrëdhënie konfliktuale mes bashkëshortëve, por reagime të tilla refuzuese prej njërit prej tyre derivojnë nga mosvlerësimi objektiv i situatës në familje me justifikimin e zakonshëm: "Të gjithë çiftet kanë probleme". Faktorë të tjerë të tillë si, frika e të mbeturit vetëm, apo paaftësia për të përballuar ekonomikisht jetesën, ndikojnë në zvarritjen e zgjidhjes ligjore të martesës. Ka gjithashtu nga ata çifte që pranojnë të kenë probleme në familje, por nuk pranojnë të divorcohen ligjërisht për hir të fëmijëve dhe mjedisit social ku bëjnë pjesë. Në bisedë me të Znj.Luljeta u shpreh për bashkëshortin: "*Jam gati të pranojë edhe lidhjet jashtë martesë që mund të ketë, vetëm ai të mos bëjë divorcin e të qëndrojë në shtëpi. Le të mos me flasi fare po të dojë.*"

1. Cilat janë shkaqet psikologjike që përcaktojnë format e divorceve?

Askush nuk lidh martesë me idenë fikse në kokë se do të divorcohet disa vite më pas. Askush nuk vjen menjëherë në gjykatë, pas një konflikti me partnerin. nëse marrëdhëniet në çift kanë qenë të mira përpara konfliktit të ndodhur. Puna e përditshme me zgjidhjet e martesave më ka treguar se është e vështirë të marrësh vendimin për divorc edhe pas një marrëdhënieje jashtë martesore të partnerit. Mosmarrëveshjet zgjasin disa muaj deri sa merret vendimi për t'ju drejtuar gjykatës.

Historitë personale të çifteve në divorc tregojnë se konfliktet janë mjaft të zgjatura në kohë përpara vendimit për divorc. Shpesh herë

neglizhimi, dhuna fizike e psikologjike kanë qenë të pranishme për një periudhë të konsiderueshme deri në momentin e veçimit të bashkëshortëve nga njëri-tjetri.

Në 71% të rasteve të analizuara prindërit dhe familjarët e partnerëve përkatës kanë ndërhyrë për 1 ose më shumë herë që të normalizojnë situatën në çift.

Vërehet se në momentin e veçimit, konflikti mes palëve ka arritur kulmin e se mllëfi, zemërimi e inati i partnerëve mes tyre apo edhe mes familjeve, do kohë që të stabilizohet, për të mos thënë se në një numër rastesh të konsiderueshme këto marrëdhënie konfliktuale vazhdojnë për vite me rradhë edhe pas divorcit.

Në një situatë të tillë tensioni, në të cilën nisin procedurat për zgjidhje martesë, bëhet i vështirë bashkëpunimi mes palëve. Vetë procesi ligjor mbart në vetvete një gjëndje të ngarkuar psikologjike të cilës duke i shtuar situatën konfliktuale në familje bën të vështirë menaxhimin e ankthit e stresit nga palët.

Në analizimin e historive personale që morën pjesë në këtë studim, në lidhje me divorcet konfliktuale doli ne pah se:

39% e grave në proces divorci raportuan se mbi to ishte ushtruar dhunë e rëndë fizike dhe psikologjike nga bashkëshorti apo familjarë të tij gjatë periudhës së martesës.

• *A.Ç raporto i gjatë intervistës se kishte vuajtur nga uria e ishte lënë pa ndihma financiare nga i shoqi dhe familja e tij në tre javët e para pas lindjes së djalit. "Nuk kisha bukë të haja. Disa ditë e kam shtyrë vetëm me një tas ullinj që më kishte sjellë mamaja" – pohon ajo. Gjatë kësaj kohe ka patur edhe episode dhune të rëndë fizike ushtruar nga bashkëshorti që e kanë çuar deri në humbjen e ndjenjave.*

• *N.N kur doli nga materniteti me të bijën e sapolindur u la të jetonte në papafingon e shtëpisë pa asnjë ndihmë ushqimore e financiare nga familja e të shoqit i cili në atë kohë punonte në emigracion. N. tregon: "Kisha një lavaman në dhomë ndërsa për nevojat personale përdorja një kovë, sepse nuk me linin të përdorja tualetin. Kam grisur e kam përdorur bluzat e mia si pelena për*

vajën për disa ditë deri sa erdhën më morën familjarët e mi nga Pogradeci."

Konflikti gjeneron në disa raste edhe nga pamundësia për të takuar fëmijët gjatë periudhës së veçimit dhe procedurave për divorc. 5% e bashkëshortëve të intervistuar raportuan se megjithë përpjekjet e bëra, nuk ishin lejuar të shihnin fëmijët e tyre nga bashkëshortja. Në disa prej rasteve ky takim nuk ishte realizuar as pas kërkesës së gjykatës e psikologut të çeshtjes. Ky fakt ka çuar në acarimin gjithmonë e më shumë të marrëdhënieve mes partnerëve.

• *S.B nuk arrinte të kontaktonte me të bijën 6 vjeçare as në telefon prej 11 muajsh, ndërkohë që bashkëshortja e tij, psikologe në profesion, shprehej se përpqej të mbronte vajzën nga papërgjegjshmëria e të shoqit në lidhje me aspektin ekonomik të rritjes dhe edukimit të saj. "Kur të nisë të paguaj pension ushqimor çdo muaj, atëhere mund të takojë vajzën" – pohoi nëna gjatë intervistës.*

Çiftet në proces divorci kanë renditur gjithashtu si shkaqe për divorcet e dhunshme dhe konfliktuale çeshtje të tilla si:

a) Çeshtjet ekonomike

58% e grave që janë në proces divorci janë veçuar nga bashkëshorti pa asnjë përfitim financiar të marrë nga martesë. Ato janë larguar nga shtëpia vetëm me fëmijët.

b) Mosmarrja e përgjegjësive të përbashkëta për mirëqënien psiko-sociale dhe ekonomike të fëmijëve.

44% e të anketuarve janë përgjigjur se nuk kanë më mbështetje nga partneri/ja në këtë drejtim, që pas fillimit të procedurave për divorc apo edhe më parë.

c) Konflikt që gjeneron nga kërkesa për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore ndaj fëmijës/ve nga secili prej prindërve.

21% e çifteve në proces divorci janë në konflikt të fortë për ushtrimin e përgjegjësisë prindërore.

d) Refuzimi i divorcit nga njëra palë.

9% e të anketuarve.

Në rastet e zgjidhjes së martesave pa konflikte të forta, të anketuarit raportojnë se:

-Martesë e ka humbur kuptimin prej disa vitesh dhe zgjidhja ligjore konsiderohet formalitet.

-Vendimi për divorc është i të dy partnerëve.
 -Ka mirëkuptim dhe bashkëpunim në lidhje me ushtrimin e përgjegjësisë prindërore të fëmijëve.
 -Të dy partnerët janë në të njëjtin stad social. Janë në marrëdhënie pune e sigurojnë të ardhura financiare.

2. Cilat janë qëndrimet e çifteve në divorc lidhur me marrëdhënien që ata mbajnë gjatë realizimit të zgjidhjes së martesës?

Çiftet që kualifikohen si jo konfliktual mes tyre, përgjigjen në pjesën më të madhe të intervistave, se komunikimi dhe bashkëpunimi gjatë divorcit dhe pas tij është në interesin e fëmijëve.

71% e të anketuarve nga kjo kategori raportojnë se, vazhdojnë të ruajnë komunikimin direkt me njëri-tjetrin në lidhje me nevojat psiko-emocionale e fizike të fëmijëve.

29% raportojnë se nuk ruajnë komunikimin direkt mes tyre, por se përdorin fëmijët si mesazherë e se nuk pengojnë komunikimin dhe takimet e fëmijës/ve me prindin tjetër apo familjen e tij/saj.

• *K.L nënë e dy fëmijëve 2 dhe 5 vjeç u shpreh në intervistën vlerësuese: "Të ishte për mua nuk do doja ta shihja më pas asaj që ndodhi (tradhëti bashkëshortore), por është babai i Kleas dhe Jonit dhe për ta është babai më i mirë. Të paktën jemi në banesa më vete."*

• *S.R babai i një vajze 13 vjeç pohoi: "Komunikimi me të ëmën është më e pakta që mund të bëjë për vajzën time. Ajo duhet të kuptojë se ne të dy e duam e shqetësohemi për të, pavarësisht problemeve mes nesh. Përpiqemi gjithashtu ta mbajmë nën kontroll që ajo të mos përfitojë nga kjo situatë e krijuar."*

Në divorcet konfliktuale 57% e partnerëve kanë humbur komunikimin mes tyre si dhe me familjet përkatëse. Partnerët shfaqen refuzues ndaj njëri-tjetrit dhe shmangin kontaktet edhe gjatë pritjes për seancat gjyqësore në korridoret e gjykatës.

Një pjesë e partnerëve në divorc janë njëkohësisht në proces për lëshim urdhër mbrojtje të kërkuar për ushtrim dhune nga partneri/ja ose kanë përfunduar procedurat për urdhër mbrojtje.

Në divorcet konfliktuale në lidhje me qëndrimet e bashkëshortëve mes tyre konstatohet se:

Bashkëshortët shfaqin qëndrime armiqësore e tentojnë të krijojnë imazhin e një bashkëshorti/eje dhe prindi të papërgjegjshëm për partnerin.

61% e rasteve të analizuara partneri konsiderohet si prind i papërgjegjshëm

12% % e rasteve të analizuara partneri/ja konsiderohet si prind negativ që nuk duhet të ketë kontakte me fëmijën/ët.

Në divorcet konfliktuale vërehet gjithashtu se familjet e bashkëshortëve në divorc janë të ngarkuar negativisht ndaj nuses/dhëndrit, gjë të cilën e shprehin dhe transmetojnë edhe tek fëmijët e çiftit.

PËRFUNDIME

Qëllimi kryesor i këtij studimi ishte të nxirrte në pah trendin e mënyrave të divorcimit të çifteve shqiptarë, shkaqet e tyre si dhe qëndrimet e palëve ndaj marrëdhënieve në çift gjatë procesit të divorcit.

Studimi i ndërmarrë dhe shifrat e përfutuara janë iniciale për studime të mëpasshme për të parë më thellë problemet që hasin mes tyre bashkëshortët në divorc. Njohja me problemin përbën një tregues të mirë për të ndërgjegjëuar dhe parandaluar konfliktet dhe situatat e dhunshme për çiftet në divorc.

REKOMANDIME

Në të ardhmen shihet i nevojshëm një studim më i gjerë, i cili të përfshijë edhe qytete të tjera të Shqipërisë e të jetë më përfaqësues. Një studim i tillë me të dhëna me të larmishme do të prodhonte gjithashtu më shumë gjetje e do të ndihmonte analizimin e problemit.

BIBLIOGRAFIA

- 1, Eleanor E. Maccoby, Robert H. Mnookin Dividing the child: Social and legal dilemmas of custody.1992
2. M.B. Isaacs, G.H. Leon and M. Kline. When is a parent out of the picture? Different custody, different perceptions. Family Process, v.26, p.101-110, 1987.

3. Janet R. Johnston, Linda E. G. Campbell, Judith S. Wallerstein. Impasses of Divorce: The Dynamics and Resolution of Family Conflict 1999.
4. Judith S. Wallerstein, Julia Lewis, Sandra Blakeslee The unexpected legacy of divorce: a 25 year landmark study. 2001

5. www.gjykatatirana.gov.al.

6. www.balkanweb.com. .